

RAPORT VJETOR ZMR

2008

Janar 2009

Mbrojtja nga rrezatimet e popullates dhe mjedisit ne Shqiperi eshte nje proces ne vazhdimesi, i cili kerkon nje pune intensive dhe te kualifikuar te specialisteve te Zyres per Mbrojtjen nga Rrezatimet dhe te gjithe atyre institucioneve, te cilet jane te lidhur si me sigurine dhe sigurimin e materialeve radioaktive. Stafi i ZMR ka punuar ne menyre te palodhur si cdo vit ne zbatim te funksioneve qe jep ligji per mbrojtjen nga rrezatimet, ku misioni kryesor ka qene te perpujete dokumentat legale per mbrojtjen e punonjesve dhe publikut nga efektet negative te rrezatimeve duke zhvilluar dhe krijuar sistemin e administrimit dhe kontrollit te mbrojtjes nga rrezatimet, i cili siguron mbrojtjen e publikut dhe mjedisit ne perputhje dhe me standartet nderkombetare si te ANEA dhe EU. Megjithe problemet e hasura puna ne ZMR gjate vitit 2008 ka pasur nje ngritje dhe problematika per mbrojtjen nga rrezatimet ka ardhur ne renie .

Plani vjetor

Disa nga detyrat kryesore dhe objektivat qe duhen arritur gjate vitit 2008 ishin:

- Ndryshimi i elementeve bazë në lidhje me draftin e gjobave, ndryshime të cilat do të bëhen nga Drejtoria Juridike mbi bazën e draftit të përgatitur nga ZMR.
- Realizimi i inspeksioneve në rang prefekturash dhe plotësimi i të gjithë dokumentacionit.
- Përgatitja dhe miratimi i rregullores për një menaxhim cilësor të punës në ZMR.
- Testimi i inspektorëve të ZMR mbi rregulloret për sigurinë e punonjësve në ekspozimet profesionale, ekspozimet mjekësore dhe të publikut.
- Përditësimi i inventarit në sistemin RAIS.(Licencat,Leje imp-exp,transp,Inventari i burimeve njerzore per subjektet e licencuar)
- Vazhdimi i projekteve TSA1 dhe TSA2, të cilët kanë lidhje me Trupën Rregullatore, si dhe me ekspozimet profesionale dhe optimizimin
- Rishikimi dhe përshtatja e setit të rregulloreve për liçensim, punë të sigurtë, transport dhe mbetje, në përputhje me ANEA-an, si dhe me direktivat europiane në kuadër të përafrimit të legjislacionit Shqipëtar me atë European. Këto ishin disa nga detyrat te realizuar nga ZMR gjate 2008 duke pasur mbështetjen e ISHP dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Puna dhe perpjekjet qe do te behen ne vazhdimesi ne te ardhmen ne ZMR per afrimin e legjislacionit dhe dokumentacionit tone me ate te EU do te jete gjithashtu nje stimul per nje permiresim me cilesor te punes sone.

Liçensimi

Gjate vitit 2008 ka vazhduar normalisht procesi i liçensimit te perdoruesve te burimeve te rrezatimit jonizues, si nje nga detyrat kryesore të ZMR. Liçensat e leshuara janë për gjeneratorë me rreze X, për burime te mbyllura apo te hapura radioaktive, si dhe për import-eksport . Liçensimi kryhet si një proces, i cili fillon me njoftimin pranë ZMR, plotësimit të kërkesës për liçensë dhe dokumentacionit të duhur nga ana e përdoruesit, shqyrtimin e këtij dokumentacioni nga ana e inspektorëve të ZMR. Pas vlerësimit dhe inspektimit qe kryhet nga inspektorët e ZMR dokumentacioni paraqitet në KMR, e cila lëshon liçensat përkatëse. Proçesi i liçensimit tashmë është konsoliduar pasi inspektorët kanë detyra të ndara qe nga marrja në dorezim e dokumentacionit, vlerësimit të këtij dokumentacioni dhe inspektimit nga ana e tyre, me raportin përfundimtar vleresues që i paraqitet KMR. I gjithë ky proces nuk e përjashton punën në grup me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj përdoruesve.

Një element i ri i punës gjatë këtij viti është fillimi i kryerjes se ekspertizës nga fizikanë dhe jo nga inspektorët e ZMR për subjektet qe licensohen, kjo në përputhje me rekomandimet e ANEA-s, për të siguruar pavarësinë e Trupës Rregullatore në Shqipëri. Persa i takon subjekteve shtetërore ato akoma nuk jane mbuluar me ekspertize nga ana e QFBZ. Kjo eshte nje ceshtje problematike per momentin pasi kërkon pergatitjen e fizikaneve per kryerjen e ekspertizes, po ashtu dhe nga fakti i mosnjohjes se metodikes dhe detyrimeve ligjore ne kete fushe. Vete perdoruesit duhet te kene nje strukture te qarte ne kete fushe me qellim paraqitjen ne KMR te nje dokumentacioni, i cili gjate vleresimit te jete i qarte per punonjesit e ZMR.

Gjate vitit 2008 kane aplikuar prane ZMR 47 subjekte, nga te cilat 25 jane miratuar dhe liçensuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, pasi kane plotesuar te gjithë dokumentacionin sipas kerkeses per license. Pjesa tjetër është në proces plotësimi dokumentacioni.

Nga keto aplikime: 9 prej tyre jane per rinovim license, 3 amendime dhe 14 jane licensa te reja. Numri i subjekteve te liçensuara gjate 2008 te cilet kane ne perdorin gjeneratore te rrezatimit jonizues eshte 19. Jane liçensuar 6 subjekte, nga të cilat 4 perdorin burime radioaktive te mbyllura te kategorise 2, 4 dhe 5 qe operojne ne fushen e industrise dhe sigurisë ushqimore, 1 liçensë për perdorim burimi radioaktiv të mbyllur te kategorise 3 ne fushen e mjekesise, 1 license per burime te hapura per ekzaminime mjekesore, si dhe 1 liçensë për import-eksport gjeneratorë me rreze X dhe burim te mbyllur radioaktiv.

Numri i përgjithshëm i punonjësve per subjektet e licensuara është 100 .

Per sa i takon vitit 2008, liçensimi eshte i perqendruar me shume ne sektorin privat, ndersa ne sektorit shtetëror me gjithë angazhimin e ZMR ka pasur probleme, të mbartura qe nga viti 2007. Keto qendra shtetërore nuk kane plotesuar dokumentacionin per liçensim ose e kanë plotesuar pjeserisht, perveç Qendres Spitalore te qytetit te Elbasanit, Qendrës Spitalore Durrës, të cilat janë pajisur me liçensë këtë vit, ne baze te vendimit te marre ne mbledhjen e KMR. I njejtë problem ne zvarritjen e plotesimit te

dokumentacionit paraqitet dhe nga ana e subjekteve private, te cilet ne disa raste mund te shenojne nje vonese te madhe kohore deri ne paraqitjen e plote te dokumentave.


Problem kete vit ka paraqitur hapja e kabineteve radiologjike ne pallatet e banimit, qe ka hasur ne kundershtrim te banoreve te pallateve. Kabinetet radiologjike ngrihen ne ambiente qe plotesojne kushtet e Urdhërit të Ministrisë të Shëndetësisë Nr. 547, dt. 14.10.2008.

Gjithashtu, nje problematike tjeter eshte dhe mosparaqitja e subjekteve juridike ose fizike prane ZMR nje muaj para afatit te skadimit te licenses, sipas nenit 4 te Rregullores per licensim dhe inspektim te veprimtarive me burime te rrezatimit jonizues, po keshtu edhe gjate 2008 ka pasur subjekte te cilat kane plotesuar dokumentacionin dhe licensa eshte miratuar nga KMR, por nuk jane paraqitur per ta terhequr ate pranë ZMR.

Me poshte po paraqesim nje shperndarje e licensave te miratuara nga KMR me tabelen 1 dhe grafikun 1 :


Nr. i licensave	Gjeneratore me rreze X	Burime te mbyllura Radioaktive (kat.1,2,3,4,5)	Burime te hapura Radioaktive	Import-eksport
25	19 licensa	4 lic (per kat 2,3,4,5)	1	1

Grafik 1



Ne grafikun Nr. 2 jepet perqendrimi i licensimit ne sektorin privat dhe ate shteteror.

Grafiku Nr. 2



Numri i aparaturave me rreze X te licensuara ne vitin 2008: 7 mamografi, 10 Ct Skaner, 9 gr/skopi; 1 grafi industriale; 6 panoramex; 1 grafi dentare; 1 coronarografi; 1 skopi;

INSPEKTIMET

Inspektimi edhe gjate vitit 2008 perben nje nga drejtimet kryesore te punes, ne baze te ndarjes se kesaj pune te bere ne ZMR. Inspektimi ne pergjithesi ka paraprire licensimin e subjekteve shteteror apo privat per te paisur me license per mbrojtjen nga rrezatimi jonizues. Pervec kesaj qe perben pjesen me te madhe te qellimit te inspektiveve, ai gjithashtu eshte zbatuar edhe ne probleme te tjera qe kane pasur per qellim kontrollin, ruajtjen apo sigurimin e burimeve radioaktive etj.

Inspektimet jane kryer ne qendra te ndryshme mjekesore, te cilat ushrojne veprimtari me burime te rrezatimit jonizues private dhe shteterore, si dhe ne kompani te ndryshe te cilet perdorim burime te mbyllura radioactive ne fushen e industrise. Inspektimet kryhen ne zbatim te funksioneve qe jep ligji per mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe rregullorja per inspektimin dhe licensimin, kane synuar ne rritjen e rezultateve sa me te larta te detyres kryesore te ZMR. Kjo ne lidhje me mbrojtjen e punonjesve dhe te publikut nga efektet negative te rrezatimeve jonizuese, plotesimi i dokumentacionit per licensim, si dhe elemente baze qe kane te bejne me mbrojtjen nga rrezatimi sic jane justifikim, optimizim dhe doza limit. Gjithashtu gjate vitit 2008 jane kryer inspektive, ku si objekt i tyre ka qene verifikimi i dozave qe merr pacienti ne ekzaminimet rutine, mbrojtja e publikut dhe personelit nga rrezatimet jonizuese.

Me poshte po paraqesim inspektimet dhe qendrat per te cilat jane realizuar ato gjate vitit 2008 nga inspektoret e ZMR.


Subjekti	Inspektoret	kabinet rad/Burim
1. Dep. i Radiotherapise, QSUT	R.PACI/I.Pashko	Brakiterapia
2. Dep i Onkologjise, QSUT	ZMR	Cobalti
3. Spitali Ushtarak	I.Pashko	Kabinet radiol
4. Klinika "Ikeda"	I.Pashko	Kabinet radiol
5. Klinika Golloshi	I.Pashko	Kabinet radiol
6. Klinika Babrru	I.Pashko, L.Abazi	Kabinet radiol
7. Poliklinika, Kombinat	I.Pashko	Kabinet radiol
8. Spitali Rajonal Durres	R.Paci, I.Pashko	Kabinet radiol
9. Qendra Spitalore Elbasan	Sh. Arapi	Kabinet radiol
10. Spitali Fier	R.PACI/Sh. Arapi	Kabinet radiol
11. Spitali Rajonal Korce	R.Paci, Sh.Arapi, L.Abazi	Kabinet radiol
12. Spitali Diber	R. Paci	Kabinet radiol
13. Medicare, SH,El	R.Paci, I.Pashko	Kabinet radiol
14. Bechtel Enka, MR	R.Paci, L.Abazi	Burim i mbyllur
15. Soepro, VL	Sh.Arapi, R.Paci	Burim i mbyllur
16. MC.Dr. Shiroka, DR	I.Pashko.R.Paci	Kabinet radiol
17. La Vita, KV	R.Paci, L.Abazi	Kabinet radiol
18. Dogana, Porti Durres	R.Paci, L.Abazi	Skaner mobil
19. Dora e Arte, TR	R.Paci, L.Abazi	Kabinet radiol
20. Ndreu , DR	Sh.Arapi	Kabinet radiol
21. W.Atlas, Marinez	R.Paci	Burim i mbyllur
22. QFBZ,	Sh.Arapi.R.Paci	Laboratori i Mbetjeve
23. Klinike dentare, Libofshe	Sh.Arapi	Kabinet radiol
24. Kurum, Elbasan	R.Paci, Sh.Arapi	Burim
25. Kurum, Elbasan	Sh.Arapi	Burim

Inspektimet e kryera gjate vitit 2008, te cilat perbejne nje komponent te rendesishem te ZMR, jane ushtruar si veprimtari e bazuar ne kerkesat e ligjit per mbrojtjen nga rrezatimet si dhe ne rregulloren mbi licenimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime te rrezatimit jonizues. Duhet theksuar qe eshte rritur interesimi nga ana e subjekteve per te marrë mendimin paraprak dhe te kualifikuar prane ZMR per ndertimin e kabineteve te rinj radiologjike.

Shperndarja per ekspertizat dhe vlersimet

Subjekti	Ekspertiza	Vleresim
MC.Dr,Shiroka	+	+
Medicare	+	+
Klinika Ikeda		+
Kl.dentare Babrru	+	+
Spitali rajonal Durres	+	+
Brakiterapia	+	+
ISUV		+
Biometric Albania		+
Western Atlas		+
Kl.Golloshi		+
Joad Farma		+
Klinika Ortodokse		+
Medison		+
Royal Diagn.		+
Kl.Mirjam		+
Nasto inxhiniering		+
Amendim QFBZ		+
Medical Product	+	+

Ne grafikun e meposhtem tregohet nr i ekspertizave, vleresimeve dhe inspektimeve te kryera gjate vitit 2008



Gjate inspektime janë vërejtur dhe probleme të tilla, të ngritura si shqetësim dhe nga ana e subjekteve kryesisht ato shtetërore, si :

- dozimetria personale në subjektin shtetëror, si kusht për të siguruar një mbrojtje sa më të mirë për personelin punonjës.
- Mosplotësimi në kohë i dokumentacionit për licensë.

Si pjesë të kësaj pune mund të përmendet edhe seminari në nivel kombëtar i zhvilluar në Qershor 2008 me radiologe të rrethëve për problemin e inspektimit të kabinetëve radiologjike për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese.

Duhet të përmendet dhe inspektim-vlerësimi i nivelit të radonit në 15 shkollë të qytetit të Tiranës, në bashkëpunim me Institutin e Gjeofizikës. Inspektimi ka mbaruar dhe tashmë po bëhet vlerësimi, proces në vazhdim që do të na japë një tablo, nga i cili mund të marrim një informacion që është me vlerë për zyrën tonë për këtë problem të rëndësishëm.

Duke e konsideruar këtë çështje tepër të rëndësishme e cila ndikon drejtpërdrejt në rritjen e cilesore të zbatimit të detyrës kryesore të ZMR, pra në rritjen e sigurisë në punën me burimet jonizuese sqarohet se:

Cilesia e inspektimit dhe për pasojë edhe e elementeve të tjera deri në licensim, kur atë e kërkon subjekti që trajtohet, ka një rritje kundrejt një viti më parë për arsyet e mëposhtme:

- Zyra jonë ka futur në praktiken e punës së saj metodën e punës në grup, fale idesë dhe këmbënguljes të Kryetarit të ZMR Z. R.Paci. Gjate vitit që kaloi është kuptuar dhe zbatuar me së miri kjo gjë, për arsye se në ndarjen e punës midis anëtarëve të zyrës cdo njeri prej tyre përfaqëson një hallkë dhe si rrjedhojë e bashkërendimit me të mirë të punës midis këtyre hallkëve, kjo ka çuar në një rritje cilesore në teresinë e punës së grupit. Përfundimisht është rritur cilesia edhe në procesin e inspektimit, për pasojë edhe të licensimit.

Rritja e kërkesës ndaj vetes, subjektit dhe rritja e kërkesës nga Kryetari i zyrës; të gjitha këto elemente që cituam më lartë të marrura në teresi përbejnë një tjetër eksperiencë pozitive në punën e zyrës sonë e cila duhet ruajtur, pasuruar dhe çuar më tej.

- Përgatitja për inspektim dhe eksperiencën e fituar po ndikon pozitivisht për një inspektim me cilësor. Një tregues faktik që vërteton këtë pohim e tregon fakti se subjektet e inspektuara dhe të miratuara nga ana jonë për licensim janë miratur dhe të licensuar të gjitha nga ana e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR). Kjo përben një testim të drejtëpërdrejtë për punën tonë në grup, që përfshin punët e të gjitha hallkëve që nga përgatitja dhe shpërndarja e dokumentave për subjektet, njoftimi, inspektimi, ekspertiza, vlerësimi i punës deri në kontrollin përfundimtar nga Kryetari i zyrës.

- Në inspektimin për hapjen e kabinetëve të rinj është krijuar një "paraprite" me cilësore që lidhet me plotësimin sa më rigoroz të të gjitha kërkesave të rregullores të inspektimit licensimit për funksionin e tij konform këtyre kërkesave. Është në rritje numri i subjekteve që paraqiten pranë zyrës sonë për licensim të kabinetëve radiologjike që në idenë e ngritjes së kabinetit për të kërkuar mendime dhe ndihmë për ndertimin sipas kërkesave të mbrojtjes nga rrezatimet të kabinetëve radiologjike. Kjo mund të konsiderohet si një arritje dhe një konsolidim të punës sonë në grup që ndikon në rritjen cilesore të kësaj pune.

- Urdheri i Ministrisë të Shëndetësisë, njëkohësisht edhe Kryetar edhe i KMR-se për ndalimin e ngritjes dhe funksionimit të kabinetëve radiologjike në pallatet e banimit, është një ndihmë e rëndësishme për punën tonë pasi na jep një instrument të ri për të rritur me cilësisht masat për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese.

Disa probleme për të cilat duhet menduar për një zgjidhje përfundimtare dhe sa më të shpejta të tyre:

- Edhe njëherë theksojmë papërgjegjshmerinë për licensimin të 10 prefekturave të vendit për kabinetet radiologjike në këto prefektura. Kjo papërgjegjshmeri ndikon drejtpërdrejt në punën tonë, në dukje si të përealizuar. E vërteta është krejt ndryshe, të cilët e njohin të gjithë, por që do një zgjidhje për të vënë këto subjekte përpara një përgjegjësie për të u përgjigjur kërkesave tona ligjore ndaj tyre. Në këtë kontekst miratimi i rregullores për gjërat ndaj subjekteve që nuk u përgjigjen apo shkelin rregullat dhe ligjet që lidhet me punën tonë do të ndikojë shpesh në ndryshimin pozitivisht të kësaj situatë.

Import-Ekporti dhe Transporti burimeve të rrezatimit jonizues të kryera gjatë vitit 2008


Për sa i takon import-eksportit të materialeve radioaktive dhe gjeneratorëve me rrezex gjatë 2008 janë dhënë 49 leje importi, nga të cilat 24 janë leje importi për lende radioaktive të hapura I-131 dhe Tc-99 të cilat përdoren në mjekësinë më shumë për ekzaminime "in Vivo", 11 leje importi lende radioaktive për ekzaminime "in Vitro", 2 leje importi për Gjeneratorë të rrezatimit X, 1 leje importi për burim të mbyllur radioaktiv Ir-192 i kat 2, 1 leje importi burim i mbyllur Co-60 i kat.1, të cilat janë miratuar nga KMR, 7 leje importi për burime të mbyllura kategoria 4 dhe 5, gjithashtu gjatë vitit 2008 janë kryer dhe 3 eksporte, nga Kompania Western Atlas International si dhe një nga QFBZ.

Subjektet të cilët kanë në përdorim lëndet e mesiperme janë pajisur me leje importi duke zbatuar të gjitha procedurat për import-eksportet duke u bazuar në udhëzuesin mbi import-eksportet e materialeve radioaktive Nr.158 dt.13.02.2008 dhe kategorizimit të burimeve radioaktive nr.4756/2 dt.21/12/2006, të cilat janë miratuar nga KMR. Gjatë vitit 2008 Qendra e Radioterapisë në QSUT importoi një burim të fuqishëm Co-60, burim i kategorisë së parë, i cili do të përdoret për trajtimin e pacientëve me kancer.

Të gjitha subjektet që kryejnë importe janë pajisur me leje importi pasi ata kanë aplikuar për licensë në ZMR dhe është miratuar nga KMR.


Materialet radioactive dhe gjeneroret me rreze x te importuara dhe eksportuara	I-131, Tc-99 Medicare	Kite RIA Neo-style Kl. Jeta	Gjeneratore me rrezeX Medfau dhe QFBZ	Burim i kat 2 I-192 QFBZ	Burim i kat4 dhe 5 Kurum QFBZ B-enka Biometric-albania E-A	Burim I kategoriseI Co-60 Onkologjik	Eksporte
NR i lejeve	24	11	2	1	7	1	3

Nje shperndarje te import-eksporteve te burimeve te rrezatimit jonizues te kryera gjate vitit 2008 tregohet ne grafikun e meposhtem.



Duke krahasuar numrin e import-eksporteve te kryera nga subjektet gjate vitit 2008 me import-eksportet gjate 2007 ,veme re se numri i tyre nga viti ne vit nuk ka ndryshim te madh , pervec faktit se gjate ketij viti ne ndryshim nga 2007 jane kryer 3 eksporte ,nje gjenerator neutronik te cilin e kishte ne perdorim Western Atlas International, dy burime radioactive Cs-137 te cilat perdoreshin nga kjo kompani per sherbime gjeofizike dhe qe sipas kontrates me prodhuesin ne fund te punes u kthyen ne vendin e origjines, gjithashtu dhe Qendra e Fizikes Berthamore te Zbatuar eksportoit gjate ketij viti dy burime (Co-60 dhe Cm-242) te cilat u perdoren nga kjo qender per qellime kalibrimi ne Portin e Durresit.


Shperndarja e import eksporteve ne vitet 2007 dhe 2008




Transporti

Gjate vitit 2008 jane dhene 46 leje transporti. Transporti i materialeve te ndryshme radioaktive eshte kryer nga subjekte te licensuara nga KMR dhe duke zbatuar te gjitha procedurat per nje transport te sigurve te ketyre materialeve radioaktive. Qendrat e licensuara nga KMR per ushtrimin e ketij aktiviteti jane “Medicare” dhe QFBZ.

Kryesisht gjate 2008 eshte transportuar lende e hapur radioaktive I-131 dhe Tc-99 nga qendra Medicare, te cilat perdoren nga kjo qender ne mjekesine berthamore per ekzaminime “In Vivo”. Gjithashtu nga qendra Medicare eshte kryer ne baze te nje marreveshjeje dhe transporti per kliniken Neo-Style, e cila importon lende te hapur radioaktive I-125 per ekzaminime “In Vitro”. Gjate 2008 jane transportuar nga QFBZ nje burim radioaktiv i kat.II Ir-192 dhe Co-60, burim i kategorise I, gjithashtu nga kjo qender eshte kryer dhe transporti per burime te kategorise 4 dhe 5 per kompani te ndryshme si Western Atlas International, Azotiku Fier, Kompania Kurum international. Numri i transporteve te kryera gjate 2008 paraqitet ne grafikun e meposhtem .



Gjate 2008 jane dhene 24 leje transporti per lende te hapur radioaktive I-131 dhe Tc-99 , te cilat perdoren ne mjekesine berthamore, 9 leje transporti I-125 e cila perdoret per ekzaminime “in Vitro”, 13 leje transporti per burime te kat.I,II,IV dhe V .Duke i krahasuar transportet me vitin e kaluar shohim se nr i tyre gjate ketij viti ka ne rritje .Po paraqesim me grafik numrin e transporteve te kryera gjate 2007 dhe 2008.



Vendimet dhe miratimet ne mbledhjet e KMR te zhvilluara gjate 2008.

Gjate vitit 2008 jane zhvilluar prane Ministrise se Shendetesise 6 mbledhje te KMR –se ku jane marre disa vendime te rendesishme , te cilat po i paraqesim me poshte:

- Ne mbledhjen e dates 13/02/2008 eshte miratuar rregullorja e ZMR si dhe formularet e rinj per lejet :
- Import-eksport per gjeneratore me rreze X
- Import-eksport per burime te hapura dhe te mbyllura radioaktive.
- Transport te materialeve radioaktive.

VKM per import-eksportet e materialeve radioaktive dhe gjeneratore me rreze X, Nr.158 dt.13.02.2008,vendim I cili rregullon import-eksportin e materialeve radioaktive prej territorit te shqiperise dhe tranzitin neper territorin doganor te Shqiperise.

Ne baze te ketij vendimi Lejet e import-eksportit per burime radioaktive te Kat I dhe II do te jepen nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, ndersa per burime te Kat III, IV dhe V dhe per gjeneratore me rreze X do te jepen nga ZMR. Ne kete vendim theksohet se ne rast importi te gjeneratoreve me rrezeX do te kerkohet certifikata e cilesise se pajisjes brenda dy viteve te fundit nga momenti i importimit

-Ne mbledhjen e dates 04/04/2008 eshte diskutuar ne lidhje me amendimet ne ligjin nr 8025 dt.9/11/1995 si dhe me komentet e bera nga ministrite e linjes, si Ministria e Drejtesise, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomise, komente te cilat u reflektuan dhe ne amendimet e ligjit.

Nje problematike per te cilen eshte diskutuar ne kete mbledhje eshte dhe siguria fizike ne lidhje me burimet e kategorise 1, 2, 3, 4 dhe 5, si dhe masat qe duhet te ndermerren nga institucione si QFBZ dhe QSUT ne lidhje me sigurimin fizik te burimeve te kategorise 1 dhe 2, te cilave u eshte derguar dhe nje shkrese zyrtare ne lidhje me kete problem.

-Ne mbledhjen e dates 12/06/2008 eshte miratuar:

-Rregullore “Per sigurimin fizik te materialeve radioaktive” e cila eshte ndertuar mbi bazen e Kodit te drejtimit, dokumentave mbi sigurine fizike te IAEA-se si dhe eshte pershtatur me direktiven 2003/13 te KE ,e cila do te hyje ne fuqi me 1 Janar 2009.

-Diskutuar mbi marreveshje e mirkuptimit midis Drejtorise se Pergjithshme te Doganave dhe KMR-se e cila ka si qellim percaktimin e rolit dhe pergjegjesive qe ka KMR ne lidhje me import-eksportin e materialeve radioactive , per te pecaktuar veprimet qe duhet te ndermare secila pale ne procesin e sigurise dhe sigurimit te materialeve radioactive si dhe vendosja e pikes se kontaktit per dy institucionet

-Diskutuar marreveshje mirkuptimi midis Drejtorise se Pergjithshme te Policise se Shtetit dhe KMR,e cila ka si qellim percaktimin e pergjegjesive qe kane te dy institucionet ne procesin e sigurise dhe sigurimit gjate transportit te materialeve radioactive , mbeshtetjen e KMR nga kjo Drejtori me ekspertize per sa i perket sigurise fizike per burimet e kategorise I dhe II si dhe vendosjen e pikave te kontaktit nga te dy institucionet.

Nje problematike per te cilen eshte diskutuar ne KMR, eshte dhe ndertimi i kabineteve te radiologjise ne godinat me destinacion banim.

-Mbledhja e dates 18/07/2008

- Miratimi i formatit te ri te lejes per import-eksport te burimeve te katI dhe II.

- Miratimi i lejes nga KMR ne baze te VKM per import-eksportin e burimeve radioactive nr nr.158 dt.13.02.2008 per importin e burimit te Co-60, i cili do te perdoret nga Departamenti i Radioterapise per trajtimin e pacienteve me kancer.

-Mbledhja e dates 02/10/2008

- Miratimi nga Parlamenti Shqiptar i amendimeve te ligjit 8025 dt.9.11.1995”Per mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, nr.9973 dt.28.07.2008

-Miratimi i rregullores:“Per pune te sigurte me burime te rrezatimit jonizues”

- Miratimi i urdherit nr.409 dt.26.09.2007 ku termi miratim nga fqinji I pare eshte zevendesuar me termin justifikim,optimizim dhe doze limit, ku justifikimi do te jete objekt i MSH dhe lidhet me politikat e shendetit qe ndiqen ne drejtorine e MSH Perjashtohen nga ky urdher katet e para te cilat kane hyrje te vecante nga publiku.

Ne lidhje me ekspertizen per kabinetet e radiologjise KMR vendosi qe per kryerjen e saj te jete detyre e perdoruesit, deri ne momentin kur QFBZ te jete gati per realizimin e saj.

-Mbledhja e dates 27/11/2008

Diskutimi ne lidhje me rregulloret :

“Per licensimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime te rrezatimit jonizues”

“Per menaxhim e sigurte te mbetjeve radioactive”, te cilat do te kalojne per miratim ne KM.

KMR miratoi:

-Udhezuesin “Per shkallen e penalizimit per shkeljet administrative te parashikuara ne ligjin nr 8025, dt.9/11/1995 I ndryshuar.

-Proces-Verbalin

-Vendimin

-Udhezuesin per tarifat e licensimit te aktiviteteve me burime te rrezatimit jonizues

Ne mbledhjet e KMR eshte diskutuar dhe per probleme te ndryshme si vazhdimi i projekteve TSA1 dhe TSA2, te cilat perfshijne forcimin e trupes rregullatore per kontrollin e malrave radioactive si dhe kontrollin e ekspozimeve profesionale dhe optimizimin.

Eshte diskutuar gjithashtu dhe ne lidhje project ligjin “Per licensat dhe lejet ne Republiken e Shqiperise”, i cili ka si qellim reduktimin e barrierave administrative ndaj nismes se lire. Ne baze te ketij project ligji licensat dhe lejet do te jene kompetence e QKL (Qendra Kombetare e Licensimit).

Po keshtu nje pike tjeter diskutimi kane qene dhe projektet IPA 2009, ku ZMR ka pergatitur ne document me idete baze i cili do te vleresohet nga eksperte te EU gjate periudhes Dhjetor 2008-Mars2009.

Trajnimi

Gjate vitit 2008 nje rendesi e vecante i eshte kushtuar dhe trajnimit te stafit te ZMR-se. Gjate ketij viti me suportin e IAEA dhe Ambsades se Shteteve te Bashkuara (EXBS) jane organizuar mjaft kurse rajonale dhe ëorkshop ne vende te ndryshme. Keto trajnime kane qene mjaft te vlefshme ne perfitimin e dijeve te cilat do te na ndihmojne ne lidhje me punen tone te perditshme. Gjithashtu keto agjensi ne kane mbeshtetur dhe nga ana teknike duke na dhuruar pajisje te rrezatimit jonizues. Gjithashtu përmendim dhe trajnimin e kryer pranë ZMR te një laboranteje, personel i Spitalit Ushtarak, në lidhje me mbrojtjen bionukleare.

Administrimi

Problem mbetet gjithnje mbeshtetja logjistike per ZMR .Sigurimi I sitemit te mirbajtjes se pajisjeve dhe kompjuterave eshte nje problematike hsume serioze per ZMR. Po keshtu dhe sigurimi mbeshtetjes ma makine per transport. Per reth nje vit nuk mbeshtetemi me makine.